



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 7  
Prishtinë, më 20 dhjetor 2017, në orën 12:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225-

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Driton Selmanaj, Verica Çaraniq, Shqipe Pantina, Albert Kinolli, Mërgim Lushtaku, Ali Lajçi, Avdullah Hoti dhe Zafir Berisha

**Munguan:** Blerim Kuçi, Faton Topalli dhe Andin Hoti.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Antigona Ibraj dhe Mehmet Simnica.

**Pjesëmarrësit tjerë:** Shkëlqim Xhema, ZKA; Gramoz Paçarada, KDI; Blerta Bejtullahu, EU; Norë Shabani, Koha Ditore; Ymer Shatri dhe Fitore Shatri nga Kompania Audituese „Audit & Conto” dhe Mentor Hyseni, GIZ.

**Mbledhjen e kryesoi:** Driton Selmanaj, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 11.12.2017;
3. Shqyrtimi i raporteve të auditimit për raportet financiare dhe atyre të deklarimit financiar të subjekteve politike për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016;
4. Të ndryshme.

*Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

### **1. Miratimi i rendit të ditës;**

*Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.12.2017;**

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 11.12.2017, u miratua pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi i raporteve të auditimit për raportet financiare dhe atyre të deklarimit financiar të subjekteve politike për vitet 2013,2014,2015 dhe 2016;**

**Kryetari** paraqiti para deputetëve disa të dhëna nga raporti i Auditimit për raportet financiare dhe atyre të deklarimit financiar të subjekteve politike. Raporti është hartuar nga Kompania audituese Audit & Conto dhe me këtë e hapi diskutimin.

**Ymer Shatri**, paraqiti para deputetëve të gjeturat si dhe rekomandimet nga Auditimi i PVF-ve dhe raporteve të deklarimit financiar të subjekteve politike si në vijim: Të gjitha Subjektet Politike nuk kanë personel adekuat me certifikata nga fusha e kontabilitetit dhe auditimit. Raporte financiare nuk janë të hartuara sipas standardeve të kërkuara për raportim Financiar. Kontabiliteti i subjekteve politike, nuk mbahet ne softuerë adekuatë , kjo mbahet përmes exelit, ku të dhënat janë edhe vështirë të kalkuloohen dhe nuk janë të besueshme. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pranon raportet financiare nga subjektet politike në formën e dorëzuar pa i analizuar fare ato. KQZ-ja nuk ka kuadro të mjaftueshme dhe profesionale për ti analizuar raportet financiare të subjekteve politike etj. Po ashtu, mbi 90% të opinioneve të dhëna në këto raporte kanë vlerësimin jo të mirë, vetëm 10% të raporteve janë klasifikuar me opinion të mirë e veçanërisht raporte e fushatës. Pra këto ishin në pika të shkurtra disa nga të gjeturat e Auditorit të jashtëm në raportet financiare të subjekteve politike.

**Driton Selmanaj, kryetar:** Jemi dëshmitar se zbrazëtitat ligjore të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, kanë sjell një situatë që subjektet politike mos të përgatitin raporte financiare, si dhe mosauditimi i këtyre raporteve nuk është bërë për një kohë të gjatë. Mendoj se në Ligjin e ri për financimin e subjekteve politike, duhet të eliminohen të gjitha të metat dhe dobësitë, si në mënyrën e financimit, raportimit si dhe auditimit të raporteve financiare të subjekteve politike. Do të doja që Auditori i jashtëm të na përgatitë një listë me të metat dhe dobësitë e Ligjit aktual për financimin e subjekteve politike.

**Avdullah Hoti**, tha se Auditori i jashtëm ka kryer një punë të mirë duke përgatitur një numër të madh të raporteve për një kohë relativisht të shkurtër kohore. Nga 50 raste, auditori ka mohuar opinionin apo 45% te tyre. Dhe në 48 raste të tjera, auditori ka dhënë opinionin jo të mirë. Pyeti pse kjo ka ndodhë, për shkak se auditori nuk ka pasur në dispozicion materialin e nevojshëm për shqyrtim apo ka pasur mungesë tjetër të bashkëpunimit me entitete të auditimit? Po ashtu, ju lus ti jepni 4-5 raste se si keni ardhur deri te kualifikimi i opinionit?

**Ali Lajçi**, përmendi se shumica e të gjeturave të auditorit janë të qëlluara. Këto raporte prezantohet në pasqyrën reale të gjendjes financiare të subjekteve politike, si dhe transparencës financiare, të këtyre raporteve. Nga praktika e qeverisjes se deritashme vërehet edhe mënyra e menaxhimit të parasë së vetë subjekteve politike. Transparenca financiare e subjekteve politike ka munguar gjithherë.

**Shqipe Pantina**, tha se të dhënat e paraqitura në këtë raport, janë pasqyrë reale e një organizimi jo të mirë të hartimit të raporteve financiare brenda vetë subjekteve politike. Ju besoj këtyre raporteve. Të gjeturat janë reale dhe të sakta. Më shqetëson fakti pse nuk ka pasur ndëshkime për ato subjekte që nuk kanë respektuar ligjet për shpenzimet të parasë publike. Mendoj se kishte me qenë mirë që këto raporte t'i analizojnë përfaqësuesit nga GIZ-it, me kusht që deputetët të kenë një pasqyrë më reale të gjeturave dhe rekomandimeve.

**Zafir Berisha**, theksoi se nga raportimi i auditorit të jashtëm vërehet saktë se të gjitha subjektet politike pa përjashtim raportet financiare nuk i kanë përgatitur sipas standardeve të zbatueshme në Kosovë. Po ashtu, KQZ-ja nuk ka qenë në nivel të detyrës. Problem për këtë është edhe moszbatimi i reformës zgjedhore. Mendoj për këtë duhet të del një rekomandim nga KMFP-ja.

**Mërgim Lushtaku**, theksoi se koha e shkurtër e auditorit të jashtëm për hartimin e këtyre raporteve nuk garanton cilësinë e raporteve. Subjektet Politike pa përjashtim kanë neglizhuar në hartimin e raporteve financiare. Si PDK, nuk jemi të kënaqur me punën e auditorit të jashtëm, vetëm dy auditorë kanë punuar në këto raporte. Disa të gjetura nuk qëndrojnë. Drafti fillestar me draftin përfundimtar ka dallime të mëdha. Vërejtje tjetër është se nuk është respektuar Ligji i Prokurimit Publik nga subjektet politike, etj.

**Albert Kinolli**, tha se dy rekomandimet e fundit njëra për KQZ-ja dhe tjetra për Subjektet Politike, të dhëna në raportin e auditorit të jashtëm. Pyeti se për këtë a është njoftuar KQZ-ja nga Operatori Ekonomik? Një e gjetur tjetër është sa i përket raporteve financiare që përgatisin subjektet politike për sa i përket shpenzimeve për grupet parlamentare, a kanë qenë subjektet politike të obliguara të raportojnë për këtë? Po ashtu, Kinolli përmendi edhe rolin dhe rendësinë e KMFP-së në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe rëndësinë e këtij komisioni në shqyrtimin e raporteve të auditorit të jashtëm në përgjithësi.

**Besa Shatri**, u përgjigj në të gjitha pyetjet e parashtruara të deputetëve. Ajo theksoi se auditorët në shumicën e rasteve kanë pasur problem në dhënien e opinionit për shkak se një numër i subjekteve nuk i kanë dorëzuar raporte fare apo cilësia e raporteve të dorëzuara ka qenë e nivel të ulët. Pra, në përgjithësi me tepër se gjysma e raporteve kanë opinionin e auditorit të jashtëm si të kualifikuar që i bie opinion jo i mirë. Për të përmirësuar këtë kërkohet nga çdo Subjekt Politik që të ketë zyrtar financiar të certifikuar për të përgatitur dhe për të hartuar raportet financiare.

**Avdullah Hoti** kërkoi nga operatori ekonomik që të sillte një listë në KMFP se çka do të duhet të ndryshojë në Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike.

**Driton Selmanaj, kryetar**, shtoi se shumica e të gjeturave janë për shkak se Ligji për Financimin e Subjekteve politike ka pasur zbrazëtira. Ky ligj pritet të ndryshohet, kështu që do të ishte mirë që operatori ekonomik të na sjell një listë me vërejtjet e konstatuara në Ligjin aktual për financimin e subjekteve politike, me të vetmen arsye, që të mund t'i adresojmë këto të meta. Në kohën kur Ligji i ri të vjen në Kuvend për shqyrtim. Ne kemi përgatitur disa rekomandime për KQZ-në dhe për MF-në, nëse jeni të mendimit ne mund ti adresojmë qysh tani.

*Përfundim:*

*KMFP-ja shqyrtoi raportet e auditimit për raportet financiare dhe atyre të deklarimit financiar të fushatës së subjekteve politike për vitet 2013,2014,2015 dhe 2016. Me këtë i hapi rrugë KQZ-së që të njëjtat ti publikojë ne Ueb faqe të KQZ-së, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike.*

**4. Të ndryshme.**

**Kryetari** njoftoi deputetët se më 27.12.2017, do të mbahet mbledhja e radhës së KMFP-së për ti shqyrtuar raportet e Auditimit për Kompanitë për Menaxhimin e Mbeturinave, ashtu siç është paraparë në planin e punës së Komisionit

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

\_\_\_\_\_  
**Driton Selmanaj**